



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

RELACION

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM

2019-2021

(faza I)

I. Legjislacioni mbi të cilin është mbështetur hartimi i parashikimit afatmesëm i të ardhurave 2019-2021

Misioni i këtij buxheti ashtu si dhe gjithë buxhetet e hartuar edhe më parë nga Bashkia Maliq është të jetë gjithpërfshirës, i paanshëm, perceptues, transparent, por **mbi të gjitha është të jetë i ligjshëm.**

Në këtë kuadër hartimi i parashikimit afatmesëm i të ardhurave është i përgatitur në mbështetje të ligjit.

- a. Ligjit nr.115/2014 datë 31.07.2014 “Për ndarjen Administrative Territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”ndryshuar.
- b. Ligjit Nr 9632 datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- c. Ligjit Nr 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- d. Ligjit Nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.
- e. Nr. 68/2017 Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore .
- f. Ligjit nr 9936 datë 26.06.2008 “për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- g. Ligjit nr 9975 datë 28.07.2008, ”Për Taksat Kombëtare”
- h. Udhëzimet përkatëse për parashikimin afatmesëm 10/1 datë 28.02.2017, 10/2 datë 13.07.2017.

Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve është mbështetur në nenin 34 të ligjit nr.68/2017 “ Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” thuhet:

Raporti për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për:

- a) dy vitet para vitit buxhetor;
- b) vitin buxhetor;
- c) tre vitet e ardhshme buxhetore.

2. Në këtë raport përfshihen:

- a) metodologjia e përdorur për parashikimet afatmesme të të ardhurave;
- b) analiza të efekteve të politikave të reja fiskale ose të ndryshimit të atyre ekzistuese;
- c) analiza e risqeve dhe masave për përballimin e tyre

1. Vështrim i përgjithshëm

1.1 Situata e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Bashkia Maliq është pjesë e Qarkut të Korçës dhe kufizohet me Bashkitë Devoll, Pustec, Korçë, Gramsh, Skrapar e Pogradec. Ka një sipërfaqe 656.34 km² e një popullsi 63.326 banorë dhe 18.576 familje.



Ajo përbëhet nga 7 Njësi Administrative (NJA):

Maliq, Libonik, Pojan, Pirg, Gorë, Moglicë, Vreshtas.

Në përbërje të tyre këto NJA përfshijnë gjithsej 1 qytet-Maliq dhe 81 fshatra.

Familjet.

Bashkia Maliq përbëhet nga 18.576 familje ku peshën më të madhe e zë NJA Pojan me 4,901 familje, NJA Libonik 3,145 familje. Aktualisht trajtohen me ndihmë ekonomike 1,688 familje ose 9 % e totalit të përgjithshëm të tyre. Gjithashtu trajtohen edhe 1,988 persona me aftësi të kufizuara.

Biznesi.

Në territorin e Bashkisë Maliq ushtrojnë aktivitetin e tyre 742 biznese nga të cilat 608 janë aktivë dhe 134 rezultojnë të pezulluar.

Arsimi.

Bashkisa Maliq ka 60 shkolla nga të cilat 7 të arsimit të mesëm dhe 53 të arsimit 9-vjeçar dhe fillor.

Numri i klasave në total është 342, me 6,505 nxënës dhe 549 mësues.

Bujqësia dhe blegtoaria.

Sipërfaqja e tokës bujqësore gjithsej figuron 24,224.6 ha, nga të cilat 21,757 ha tokë arë, 232.7 ha pemtore, 430.39 ha vreshtë. Në lidhje me blektorinë në Bashkinë Maliq kemi 9.834 blektorë me 11.416 gjedhë, 82.075 të lështa, 22.504 të hirta, 11.119 zgjoje bletoje dhe 1.047.017 shpendë.

1.2 Çështje kryesore për projektet dhe politikat e bashkisë

Bashkia Maliq aktualisht nuk ka një Plan të Përgjithshëm Vendor deri në këtë moment. Kemi vetëm një Plan Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) por që nuk është efektiv dhe kërkon ndryshim të plotë e përshtatje me ndarjen e re administrative-territoriale.

Për momentin kemi një zhvillim pozitiv prej Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me të cilën kemi lidhur një akt-marveshje për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Maliq. Marveshja është nënshkruar me Nr. 1795 Prot., datë 08.05.2018 midis palëve ku janë përcaktuar edhe kushtet dhe hapat që do të ndiqen në bashkërendimin e punës nga institucionet përkatëse.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes së sipërcituar, e cila ka startuar pozitivisht procesin e ndërmarrjes së nismës dhe më pas të miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Kryetari i Bashkisë, në bazë të kompetencave që i janë parashikuar në legjislacion, ka dalë me Vendimin Nr.15, datë 15.05.2018 “Për marrjen e nismës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Maliq”, me anë të së cilit janë përcaktuar pikat kyçe që do të ndiqen për hartimin e dokumentacionit të nevojshëm të nismës, sipas përcaktimeve të nenit 53, pika 3, të VKM Nr.686, datë 22.11.2017 “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”.

Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, i cili është publikuar dhe në Regjistrin e Intergruar të Territorit brenda afatit ligjor, me në fokus transparencën e procesit në çdo hap të tij, është njoftuar paraprakisht Këshilli i Bashkisë Maliq, për ndërmarrjen e kësaj nisme, me anë të shkresës Nr.1988 Prot., datë 21.05.2018.

Mandej për të patur një organizim sa më efikas dhe produktiv, është ngritur grupi i punës me specialistë të Bashkisë, nga struktura të ndryshme të saj, të cilët do të bëjnë të mundur mbledhjen e dokumentacionit dhe informacionit të nevojshëm dhe të domosdoshëm për miratimin e nismës në Këshillin e Bashkisë dhe bashkërendimin e punës me AKPT.

Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Maliq, vjen si detyrim ligjor në zbatim të Ligjit Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, gjithashtu edhe për shkak të gjendjes ekzistuese dhe problematikat e zhvillimit të territorit, orientimit të zhvillimit të territorit, kërkesave për ndërtime dhe balancimi i interesave publike dhe private në drejtim të zhvillimit territorial.

Finalizimi i Planit të Përgjithshëm Vendor do të jetë një ndër arritjet kryesore në fushën e planifikimit të territorit të një bashkie të re, të krijuar pas reformës territoriale dhe me dëshirën e vullnetin për t'iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave afatgjata të qytetarëve, si dhe për të përballuar sfidat e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit

Në lidhje me Projekt-Buxhetin Afatmesëm 2019-2021 si shtyllë kryesore kemi përcaktuar transparencën e finacave publike e cila preket edhe në strategjinë e menaxhimit të financave publike, vizioni i së cilës është të krijojë një sistem llogaridhënie, disipline fiskale dhe efikasitet në administrimin dhe përdorimin e fondeve me qëllim final zhvillimin ekonomik të njesisë.

Programi Buxhetor Afatmesëm i Bashkisë Maliq është hartuar në bazë të programeve të zhvillimit të të gjithë zonës urbane dhe rurale e cila lidhet me funksionet respektive të pushtetit vendor të përcaktuara. Objektivat e çdo programi janë përcaktuar nga grupet e punës dhe drejtuesit e çdo programi. Bazë e prioritetëve tona kanë qënë kërkesat e qytetarëve të

cilat janë bërë prezent në takimet e zhvilluara për buxhetimin me pjesmarrje. Hartimi i PBA përbën një proces shumë të rëndësishëm për ne ,pasi ky dokument siguron mekanizmat e nevojshëm përmes të cilave objektivat tona bëhen të realizueshme.

Buxheti në qëndër do të ketë qytetarin, rritjen e mirëqënies, rritjen ekonomike, rritjen e aksesit dhe të cilësisë të jetës , duke rritur besimin e dyanshëm, gadishmërinë për të kontribuar .

Objektivat e PBA-së.

a.Përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve publike dhe rritja e eficientë së përdorimit të fondeve buxhetore është objektivi parësor i PBA-së,në funksion të të cilit angazhimi dhe mbështetja me përgjegjësi të lartë e të gjitha njësive pjesmarëse ngelet thelbësore në ecurinë e suksesshme të këtij procesi.

b.Sigurimi i një shpërndarje dhe përdorimi efektiv dhe eficient i burimeve është objektivi nëpërmjet të cilit synohet të arrihet.

-Një kuadër i qëndrueshëm planifikimi afatmesëm brenda të cilit të planifikohen buxhetet vjetore.

-Forcimi i lidhjes mes programeve dhe alokimit të burimeve.

Qëllimet e PBA-së

-Shpërndarja efektive e burimeve.

-Zgjerimi i vizionit të procesit të buxhetimit.

-Parashikim më i mirë buxhetor mbështetur në objektiva dhe prioritetet për një periudhë 3-vjecare.

-Rritja e efektivitetit dhe eficientë së shpenzimeve publike.

-Forcimi i disiplinës fiskale.

PRIORITETET AFATMESME 2019-2021

Prioritetet afatmesme të reflektuara në PBA 2019-2021 janë mbështetur në kërkesat e qytetarëve dhe programin e Kryetarit të Bashkisë Maliq për mandatin 2015-2019.

➤ Prioritetet e PBA-së

Objektiv themelor i PBA –së do të jetë zhvillimi ekonomik - bujqësor i zonës nëpërmjet përmirësimit të të gjithë infrastrukturës i cili ka qenë problem ndër vite. Ky objektivi do të realizohet përmes investimeve konkrete në fushën e bujqësisë, sistemit rrugor, mbrojtjes së mjedisit , rehabilitimit të objekteve shkollore ,fuqizimit të rinisë dhe shtresave në nevojë, përmirësimit të institucioneve kulturore-artistike,sportive , nxitjes së biznesit ,ritjes së punësimit dhe zhvillimit ekonomik .

Shtyllat kryesore dhe synimet do të jenë si më poshtë:

- Zhvillimi ekonomik i qytetit Maliq dhe Njësive Administrative

- Nxitja e punësimit dhe sipërmarjes
- Ofrimi i shërbimeve cilësore
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore
- Garantimi i pastërtisë dhe reduktimi i ndotjes
- Rigjallërimi i jetës kulturore dhe sportive
- Rehabilitim i objekteve arsimore ,administrative,sociale

➤ Projektet strategjike

Do të synojmë me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare dhe donatorëve për realizimin e një sërë veprash të rëndësishme në infrastrukturën e Bashkisë së Maliqit . Objektivat kryesore të Bashkisë Maliq kanë të bëjnë me hartimin dhe menaxhimin e projekteve të zhvillimit strategjik ,krijimin e standartit të lartë të komunikimit me publikun, vlerësimin e problematikave ,ndjekjen dhe zgjidhjen përfundimtare të tyre duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi. Bashkia Maliq është duke hartuar Planin e Përgjithshëm Vëndon në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila është edhe financuesja e këtij projekti kaq të rëndësishëm.

1.3 Informacion financiar

Vlerësimi dhe parashikimi afatmsëm i të ardhurave dhe shpenzimeve është mbështetur në nenin 34 të ligjit Nr 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”Raporti për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave është bazuar mbi realizimet e viteve të fundit dhe të pritshmin e vitit buxhetor ,për këtë qëllim kemi përdorur dhe metodologjinë afatmesme të parashikimit të të ardhurave ,ndryshimet ligjore për paketën fiskale si dhe analizën e risqeve dhe masat për përballimin e tyre.

2.Orientimi afatgjatë i bashkisë

2.1 Strategjia e zhvillimit afatgjatë/strategjia territorial

Në lidhje me zhvillimin afatgjatë të Bashkisë Maliq ne do të synojmë një zhvillim ekonomik – bujqësor të të gjithë zonës. Vënia në funksion e aseteve të Ish-Kombinatit të Sheqerit Maliq tashmë të kthyer Bashkisë Maliq me Vendim të Këshillit të Ministrave do të jete një nga objektivat tona. Do të synojmë zhvillimin në fushat e mëposhtme:

- Zhvillimin e bujqësisë dhe blektorisë për efekt të fushës së Maliqit dhe pjesës rurale të zonave Gorë,Moglicë,Libonik dhe Vreshtas
- Zhvillimin e biznesit dhe sipërmarrjes në godinat e ish Kombinatit të Sheqerit
- Zhvillimin e turizmit dhe agrobiznesit në zonën rurale por jo vetëm
- Pjesa e kaskadës së lumit Devoll ,hidrocentrali i Moglicës dhe gjithë baseni mbledhës i saj ,besoj do të jenë një dritare e rëndësishme e zhvillimit ekonomik dhe turizmit në këtë pjesë të Bashkisë Maliq.
- Një synim i joni në të ardhmen do të jetë edhe zhvillimi bujqësor dhe vecanërisht i frutikulturës në toka të cilat ende janë të pandara dhe janë në pronësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural apo organit të vetëqeverisjes vendore.
- Në punën tonë në vazhdim do të synojmë në një zhvillim të qëndrueshëm të:
 - Shërbimeve publike vendore

- Menaxhimin e rrugëve dhe transportit publik
- Arsimit parauniversitar dhe edukimit
- Kujdesit Social
- Strehimit dhe planifikimit të territorit
- Zhvillimi ekonomik dhe punësimi
- Kultura dhe turizmi
- Zhvillimi i rinisë dhe sportit
- Planifikim, menaxhim dhe administrim
- Rendi dhe mbrojtja civile

2.2 Sfidat kryesore të zhvillimit

- Plani i Përgjithshëm Vendor të cilin sapo kemi filluar ta inicijojmë do të ketë pjesë të vet edhe strategjinë e zhvillimit ekonomik të njësisë tonë . Plani Strategjik i Zhvillimit do të synojë një planifikim dhe menaxhim sa më të mirë të financave, resurseve dhe shërbimeve për një periudhë gati 20 –vjeçare . Vetë PBA do të jetë pjesë e këtij plani strategjik dhe do të ketë qëllim kryesor në vetvete efektivitetin dhe efikasitetin e financave vendore, ekonomisë dhe kryerjen e shpenzimeve publike sa më afër qytetarit.
- Lidhja e drejtpërdrejtë midis prioriteteve strategjiko–politike të qeverisë me shpërndarjen e burimeve publike të rakordura me ato të bashkisë tonë do të jetë synim për të ardhmen.
- Projekt Buxheti Afatmesëm do të jetë i orientuar mbi bazën e performancës së organit të vetëqeverisjes vendore duke përgatitur kërkesa buxhetore sa më realiste në kuadër të PBA-së dhe Planit të Përgjithshëm Vendor me qëllim që të sigurojë një shpërndarje të fondeve buxhetore e të reflektojë qellimet e politikës gjatë një periudhe afatmesme 3-vjeçare. Është e rëndësishme të kihet parasysh që përgatitja e buxhetit vjetor është pjesë përbërëse e programit buxhetor afatmesëm.
- Sfidat kryesore të zhvillimit do të jenë primare në punën tonë të përditshme duke patur si bazë një plan të përgjithshëm sa më realist, gjithëpërfshirës dhe sa më afër komunitetit.

3. Projektet kryesore të PBA-së 2019-2021

3.1 Paraqitja e projekteve kryesore–arsyet dhe përfituesit

1. Infrastruktura Vendore

- a) Rivitalizim Urban Bulevardi Maliq-Drithas **224 milion lekë**
 - Është projekti prioritar i Bashkisë Maliq pasi lidh qendrën administrative Maliq me rrugën nacionale dhe NjA kryesore të saj. Përfituesit janë të paktën 65,000 banorë të Bashkisë Maliq të cilët e përdorin këtë aks për shërbimet që marrin pranë qendrës Maliq.

b) Sistemim –Asfaltim rrugë të brendshme,Rrj,Ujesjellsit+KUZ Fshati Zvirine (100 Fshatrat)-
272 milion lekë

- Është i përfshirë në 100 fshatrat prioritarë nga ana e Qeverisë Shqiptare dhe në vetvete përfshin gjithë infrastrukturën nëtokësore dhe mbitokësore duke ju shërbyer mbi 1500 banorëve të fshatit si dhe pjesës tjetër që do e vizitojë për efekt agrobiznesi e turizmi.

c) Sistemim -Asfaltim rrugë të brendshme+KUZ fshati Vloçisht- **288 milion lekë**

- Është projekt që i shërbem mbi 2500 banorëv. Arsyeja e përfshirjes së këtij projekti në prioritetë është nevoja për infrastrukturë të munguar prej më shumë se 25 vjet

d) Sistemim -Asfaltim rrugë dytesore Qyteti Maliq Maliq **-105 milion lekë**

- Ju shërben minimalisht 6000 banorëve të qytetit Maliq ,. Degradimi I disa rrugëve dhe shesheve e bën te domosdoshme këtë ndërhyrje.

2. Objekte Social Ekonomike-Kulturore

a) Qendra Komunitare-Kulturore “Dhimitër Orgocka” Maliq **-188 milion lekë**

- Është kthyer në një domosdoshmëri pas djegjes dhe daljes jashtë funksionit të kësaj godine kaq të rëndësishme. Duam ta kthejmë në një qendër komunitare për të gjithë Bashkinë Maliq.

3. Ujësjiellës Kanalizime

a) Ndërtim Ujesjelles Mançurisht +Plasë **-112 milion lekë**

- Është një projekt rajonal I cili mendohet te furnizojë me ujë fshatrat Burimas-1036 banore, Kreshpanj-371 banorë, Pendavinj-700 banorë, Rrembec-1700 banorë, Orman 1800 banorë pra në total përfituesit shkojnë rreth 6000 banorë

b) Rikonstruksion i rrjetit ujesjelles i fshatit Bregas **-52 milion lekë**

- Është tej I amortizuar dhe do ju shërbejë mbi 1600 banorë. Shumë I rëndësishëm.

4. Ujitje-Kullim

a. Rregullator i Ri I Maliqit -

b. Thellim i Lumit Devoll -50 milion leke

c. Rikons.Stacioni Pompimit Vreshtas-

- Të tre projektet do të ndikojnë në eliminimin e përmytjeve në fushën Maliqit dhe të shtimit të kapacitetit vaditës në Rezervuarin e Podgories.
- Nga këto tre projekte përfitojnë mbi 50 mijë banorë të Njësive Administrative Libonik,Pojan, Vreshtas dhe Pirc.

5. Arsim

d. Ndërtim Palestër Gjinnazi Maliq **-59 milion leke**

- Përfitojnë 300 nxënësit e shkollës së mesme Maliq dhe komunitetit i qytetit

e. Ndërtim Palestër Shkolla e Mesme Pirc - **35 milion lekë**

- Përfitojnë 425 nxënësit e shkollës së mesme dhe 9- vjeçare Pirc dhe komunitetit

f. Ndërtim kopshte femijesh Sovjan,Sheqeras,Libonik **-60 milion lekë**

- Përfitojnë 7320 fëmijë parashkollori të cilët ndodhen në mjedise private ose të pa përshtatshme.

3.2 Plani i shpenzimeve kapitale /projektplani 2019-2021

F15 SHPENZIMET KAPITALE							
		2016	2017	2018	2019	2020	2021
Programi 1	011 Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme	25,466	29,214	90,966	50,620	50,000	55,000
Programi 2	013: Shërbime të përgjithshme	0	0	0	0	0	0
Programi 3	031: Shërbime policore	0	0	0	0	0	0
Programi 4	032: Shërbime të mbrojtjes ndaj zjarrit	0	0	0	0	0	0
Programi 5	036: Rendi publik dhe masat e sigurisë	0	0	0	0	0	0
Programi 6	041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës	0	0	0	0	0	0
Programi 7	042: Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia	30,450	80,192	23,784	0	0	0
Programi 8	045: Transporti	121,910	259,203	176,097	104,979	110,325	118,890
Programi 9	047: Industri të tjera	0	0	0	0	0	0
Programi 10	051: Menaxhimi i mbetjeve	0	0	0	0	0	0
Programi 11	052: Menaxhimi i ujërave të zeza	0	0	0	0	0	0
Programi 12	053: Reduktimi i ndotjes	0	0	0	0	0	0
Programi 13	056: Mbrojtja mjedisore	0	0	0	0	0	0
Programi 14	061: Zhvillimi i strehimit	0	0	0	0	0	0
Programi 15	062: Zhvillimi i komunitetit	646	0	200	0	0	0
Programi 16	063: Furnizimi me ujë	19,712	25,648	92,936	50,000	50,000	55,000
Programi 17	064: Ndriçimi i rrugëve	0	0	0	0	0	0
Programi 18	072: Shërbimet ambulatorie	0	0	0	0	0	0
Programi 19	081: Shërbimet rekreative dhe sportive	0	0	0	0	0	0
Programi 20	082: Shërbimet kulturore	0	0	0	0	0	0
Programi 21	091: Arsimi bazë dhe parashkollor	3,948	24,964	39,800	40,000	45,000	50,000
Programi 22	092: Arsimi i mesëm	39,605	25,170	0	0	0	0
Programi 23	096: Shërbimet plotësuese në arsim	0	0	0	0	0	0
Programi 24	101: Sëmundje dhe paaftësi	0	0	0	0	0	0

Programi 25	102: Të moshuarit	0	0	0	0	0	0
Programi 26	104: Familje dhe fëmijët	0	0	0	0	0	0
Programi 27	105: Papunësia	0	0	0	0	0	0
Programi 28	106: Strehimi	0	0	0	0	0	0
Programi 29	107: Ndihma ekonomike	0	0	0	0	0	0
Total		241,737	444,391	423,783	245,599	255,325	278,890

4. Informacion financiar

4.1 Supozimet e planifikimit

Treguesit e rritjes ekonomike varen nga rritja e fondeve buxhetore nga të gjitha burimet, Transferta e Pakushtëzuar, Transferta specifike, të Ardhurat e Planifikuara, Fondet e Deleguara, Fondet e çelura nga buxheti i shtetit për investime. Nga kqyrja rezulton se me rritje rezulton vetëm transferta e pakushtëzuar e cila për vitin 2021 ka një efekt pozitiv më të madh në krahasim me vitet e mëparshme.

4.2 Burimi i të ardhurave

Në lidhje me të ardhurat e vetë bashkisë ,pavarsisht se në pamje të parë duket se vijnë duke u ulur, sqarojmë se jemi në të njëjtat nivele me një vit më parë. Në këtë aspekt sqarojmë se po të bëjmë një krahasim midis viteve ka një rritje jo vetëm në planifikim por sidomos në realizimin e planit të të ardhurave. Kështu viti 2016 ka një realizim 88,697 mijë lekë ,viti 2017 ka një realizim 117,716 mijë lekë dhe 6 –të mujori i vitit 2018 që sapo kemi mbyllur ka një realizim 89,000 mijë lekë ose sa realizimi i të gjithë vitit 2016. Po të shikojmë tabelën e burimeve dhe të bëjmë krahasimin midis viteve nga 100,196 mijë lekë në vitin 2018 të ardhurat nga taksat lokale kanë një rritje në vitin 2019 në 109,851 mijë lekë me një rritje 9,385 mijë lekë . Të ardhurat nga tarifat vendore në 2018 janë 154,776 në mijë lekë dhe në 2019 i kemi 146,131. Kjo ulje prej 8,645 është pjesa debitore e cila nuk është llogaritur. Të ardhura të tjera nga 12,878 mijë lekë në 2018 në vitin 2019 planifikimi është 13,000 ose 122 mijë lekë më tepër. Të ardhurat nga buxheti qëndror rezulton që transferta e pakushtëzuar nga 278,457 mijë lekë shkon në 284,545 mijë lekë ose 6,088 mijë lekë më shumë. Ndërsa transferta r kushtëzuar nga 375,362 mijë lekë në vitin 2018 shkon 322,437 mijë lekë për vitin 2019 ose 52,125 mijë lekë më pak . Funksionet e deleguara ngelen në të njëjtin nivel. Burimet që gjenerojnë pjesën të të ardhurave të Bashkisë Maliq dhe që krijojnë mosrealizime gjatë viteve buxhetore janë gati 5000 familje të cilat nuk ndodhen në territorin e bashkisë aktualisht por ndodhen në emigracion apo qytete të tjera të Shqipërisë .

Parashikimi i të ardhurave për Bashkinë e Maliqit është mbështetur kryesisht në llogaritjen e kapacitetit të taksave dhe tarifave, realizimit në vite, të pritshmin e vitit 2018 dhe politikat e përcaktuara për periudhën në vijim duke u mbështetur në aktet ligjore në fuqi. Parashikimi i të ardhurave në periudhën afatmesme reflekton dhe ndryshimet e paketës fiskale për efekt të ndryshimeve ligjore por edhe për efektin e pjesës debitore nga vitet e mëparshme . Ulja e të ardhurave në buxhetin Afatmesëm ka ardhur për arsye të heqjes së pjesës së debitorëve ndër vite dhe pjesës që Kontrolli i Lartë i Shtetit kishte lënë si detyrë. Sqarojmë se buxheti i pavarur nuk është me ulje po të marim në konsideratë heqjen e pjesës së debitorëve e cila

është llogaritur në vitet e kaluara. Në punën e Drejtorisë së të Ardhurave do kihet parasysh minimizimi i informalitetit dhe rritja e numrit të tatimpaguesve ,vecanësisht atyre familjarë me të cilët kemi hasur më shumë problem.

4.3 Shpenzimet

Në lidhje me shpenzimet buxhetore sqarojme sa me poshtë:

- Bashkia Maliq me një popullsi e sipërfaqe të konsiderueshme me 81 fshatra dhe 7 NjA e ka të domosdoshme një personel të tillë për menaxhimin e të gjithë funksioneve që i janë ngarkuar me ligj.
- Vetëm në Agjencinë e shërbimit Publik ne kemi 162 punonjës të diktuar nga numri i madh i shkollave ,fshatrave të cilat kanë nevojë për shërbim pastrimi,mirëmbajtje varrezash.
- Agjencia e pyje –kullotave përvec sipërfaqeve te mëdha të pyjeve dhe kullotave të cilat fillojnë në kufi me rrethin e Devollit dhe përfundojnë në kufi të rretheve Skrapar dhe Gramsh ka patur të domosdoshme një fuqi të konsiderueshme punonjësish.Nga 7 punonjës që ne na janë planifikuar për këtë strukturë ,ne me të ardhurat tona kemi shtuar dhe 17 punonjës të tjerë për të mbuluar të gjithë territorin e bashkisë tonë.
- Agjencia ujitje –kullim nga 21 punonjës të planifikuar ,ne kemi shtuar me të ardhurat tona edhe 18 punonjës nga të cilët 16 me kohë të pjesshme.Kjo vjen për efekt të sipërfaqeve të mëdha dhe volumit të punës qe ne realizojmë në fushën e Maliqit si fusha e dytë pas Myzeqesë në lidhje me ujitje dhe kullimin.
- Agjencia e rrugëve për vetë gjatësinë e rrugëve që ne mbulojmë kemi planifikuar 26 punonjës nga të cilët vetëm 4 janë personel administrate.Theksojmë se vetëm vitin e kaluar me VKM na janë shtuar edhe 25 km rrugë nacionale për ti mirëmbajtur.
- Në strukturën e Agjencisë Kulturë –Arsim-Sport kemi 36 punonjë nga të cilët 24 punonjës janë me kohë të pjesshme për një periudhe 6-mujore pasi kemi të bëjmë me klubin e futbollit Maliq.
- Pavarsisht se numri i përgjithshëm i punonjësve është 589 nënvizojmë që 11 punonjës të strukturës administrative të Bashkisë janë vende të lira për mungesë kapacitetesh .Për arsyen e mësipërme në muajin qershor të vitit 2018 bëmë ndryshime ne buxhet duke bërë lëvizje fondesh nga pagat tek investimet në vlerë 6,000 mijë lekë.
- Niveli i investimeve do të shkojë ne rritje nga viti 2019 deri në vitin 2021 me një rritje në vlerë 28,890 mijë lekë.

4.4 Rezultati total i buxhetit

4.4.1 Detyrime të prapambetura

Nga total i detyrimeve të prapambetura prej 17,318 mijë lekë ,15,001 mijë lekë janë planifikuar të shlyhen për vitin 2018 ndërsa pjesa tjetër prej 2,317 mije do të shlyhen për vitin 2019 .Vlera prej 2,317 janë detyrime të trashëguara nga ish komunat.

4.4.2 Rreziqet financiare dhe fiskale

Rreziqet financiare kanë të bëjnë më mosrealizimin e planit të të ardhurave si rezultat i mungesës të një numri të konsiderueshëm familjesh të cilat janë larguar nga Bashkia Maliq në

qytetet të tjera apo emigracion edhe pse kanë lejën e banimit pranë Bashkisë Maliq, dhe janë përfshirë në përlogaritje. Nga ana tjetër rrezik është edhe pjesa debitore në vite .

5. Informacion për programet Buxhetore

011: Organet ekzekutive dhe legislative, çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme

Struktura përgjegjëse

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi mbulon shërbimet mbështetëse për kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ose këshillin; ai siguron planifikimin e zhvillimit të njësisë, menaxhimin e financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera të njësisë dhe të burimeve njerëzore, funksionimeve proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimin me publikun.		
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	• Administrim, operim ose mbështetje e zyrës së kryetarit të njësisë vetëqeverisjes vendore ose këshillit dhe komisioneve të këshillit ose të kryetarit të njësisë. • Komunikim i kryetarit ose këshillit me publikun.
01120	Çështje financiare dhe fiskale	• Administrim i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale; menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore, i borxhit dhe funksionim i skemave të taksimit; • Operacionet e thesarit të njësisë, zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave, shërbimet e kontabilitetit dhe auditit; • Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale.
01130	Shërbimet e përgjithshme publike	• Administratim dhe operim i shërbimeve të përgjithshme të personelit, duke përfshirë zhvillimin dhe zbatimin politikave të përgjithshme për personelin • Planifikimi i përgjithshëm dhe shërbimet statistikore, duke përfshirë formulimin, bashkërendimin dhe monitorimin, në veçanti të PZhS • Administrim dhe operim i shërbimeve të tjera të përgjithshme, si shërbimet e centralizuara të prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë operim i ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësi, parqe qendrore automjete, zyrave të printimit dhe IT së centralizuar etj.

Projekte të rëndësishme(maks. 3; burimi i informacionit: fishat e projekteve PPV/PSZh)			
Kodi projektit	Titulli dhe përshkrim i shkurtër i projektit	Fillon	Mbaron
01110	Rivitalizim Urban Bulevardi Maliq-Drithas	2019	2020
01120			
01130			

Të dhënat e programit¹	t-1	t	t+1	Trendi
Numrii stafit me kohe te plote		152	152	

Informacion financiar²						
	t-2	t-1	t	t+1	t+2	t+3
Tavani i përgjithshëm i programit				210,134	209,514	214,514
Shpenzimet bruto	134,231	178,539	259,506	210,134	209,514	214,514
Të ardhurat e programit	5,101	10,451	4,662	6,979	4,662	4,662
Shpenzimet neto	129,130	168,088	254,844	203,155	204,852	209,852
Pagat dhe sigurimet shoqërore				104,656	104,656	104,656
Investimi kapital	25,466	29,214	90,966	50,620	50,000	50,000

➤ **Politika e Programit**

Politika e këtij programi përfshin përmirësimin e funksioneve dhe menaxhimin e bashkisë, zhvillimin e kapaciteteve menaxhuese, garantimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe përdorimin me efektivitet të financave

➤ **Objektivat e programit**

- Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore
- Garantim të mbarëvajtjes të punës dhe shërbimit ndaj komunitetit.
- Mbledhje dhe përdorim me efektivitet të fondeve publike
- Rritje e numrit të bizneseve të licensuar.
- Pregatitje dhe miratim në kohë I buxhetit vjetor dhe afatmesëm.
- Menaxhimi I efektshëm I financave

➤ **Rezultatet që synohen të arihen**

- Plotësimi I strukturës së plotë të administratës.
- Përmirëimi I shërbimit ndaj komunitetit
- Sigurimi I programeve trajnuese për administratën
- Përmirësimi I eficensës së punës së punonjësve

¹Informacion për të dhëna specifike të programit, sidomos numri i stafit me kohë të plotë e kohë të pjesshme, informacion për vendorin, pajisjet teknike etj. (LFV, neni 40,3,ç)

031: Shërbimet policore

Strukturapërgjegjëse

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi mbulon shërbimet policore që janë të nevojshme për ruajtjen e rendit publik dhe për parandalimin dhe zbulimin e krimeve. Në veçanti, policia është përgjegjëse për të mbrojtur jetën, lirinë dhe pronën e njerëzve.		
03140	Shërbimet e Policisë Vendore	- Ka për detyrë të kryejë funksione në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur ata nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror; Të realizojë zbatimin efektiv të akteve të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë dhe vendimeve të Këshillit Bashkisë - Të marrë masat e duhura, duke bashkëpunuar edhe me seksionin e shërbimeve publike me qëllim zbatimin e funksioneve të bashkisë

➤ Politika e Programit

Politikia e këtij programi konsiston në ruajtjen e qetësisë, mbarëvajtjes dhe zbatimit të vendimmarjeve të Këshillit të Bashkisë apo urdherave të Kryetarit sipas legjislacionit në fuqi.

➤ Objektivat e Programit

- Parandalimi me masa mbrojtëse të të gjithave problematikave që kanë të bëjnë me rendin, qetësinë, pronën dhe çdo kompetencë tjetër të pushtetit lokal.
